

AKT THEMELIMI/STATUT

Sot më datë 10.04.2025, në cilësinë e Ortakut të Vetëm Themelues, Shoqëria aksionare “Gjoka Konstruksion” sh.a., e regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3306 datë 01.04.1994, e regjistruar në QKB, me nr. NIPT J91815014U, me aksioner të vetëm **z. Rrok Gjoka** me seli Njësia 5, Rruga: Dora D’istria, Hyrja Nr. 6, Pasuria Numër 7/637+1N2, Nr. 7/637+2N1, Z.K 8270, përfaqësuar nga Administratori Z.Rrok Gjoka, atësia Kol, amësia Galë, shtetas Shqiptar, lindur në Porav, Pukë dhe banues në TIRANË, me adresë Sefer Shima 03910117; Nd. 6; H. 1; Farkë; Mjull Bathore; 1045; Tiranë, lindur më 04/01/1951, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 034243007 dhe nr. Personal F10104114F, i cili me vullnet të plotë, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, themelon shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “Ionian Crown” sh.p.k.

Neni 1

Emërtimi

1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Ionian Crown” sh.p.k.**

Neni 2

Selia

2.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në territorin e Shqipërisë. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Tiranë, Njësia 5, Rruga: “Dora D’istria” Hyrja Nr. 2, Pasuria Numër 7/637+2-B1, Z.K 8270.

2.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë degë apo zyra përfaqësie, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është vendosur të jetë **pa afat** të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

Objekti

4.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë “Ionian Crown” sh.p.k. do të jetë:

Aktivitete të stukturës akomoduese dhe shërbime të tjera që lidhen me akomodimin, sipas standarteve të fushës, komform Ligjit Nr. 93/2015 “Për Turizmin”. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprimtari tjetër tregtare, industriale e financiare, të dobishme apo plotësuese ndaj përmbushjes së objektivit kryesor të shoqërisë, atë të investimit dhe operimit si strukturë akomoduese, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe të mos alterojnë objektin parësor të Shoqërisë.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë tregtare “Ionian Crown” sh.p.k. është 30.000.000 (Tridhjetë milion) Lekë, i cili do të jetë kontribut në para.

5.2 Shoqëria “Gjoka Konstruksion” sh.a. në cilësinë e ortakut themelues zotëron 1 (një) kuotë me vlerë sa 100% e kapitalit të Shoqërisë. Kapitali themeltar zotërohet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

Neni 6

Organi Vendimmarrës

6.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 7 Kuorumi

7.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave (30%+1).

7.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave (50%+1), janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

7.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 8

Marrja e vendimeve

8.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit (me shumicë të kualifikuar), të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin, likuidimin dhe prishjen e shoqërisë.

8.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e thjeshtë), për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve të administratorëve;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, si dhe miratimin e tyre;



- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 8.3 Çdo vendim duhet të regjistrohet në regjistrin e vendimeve, i cili mbahet pranë selisë së shoqërisë, përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e të cilit janë administratorët e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

- 9.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator, i cili do të jetë:
- Z. Erind Gjoka**, atësia Rrok, shtetas Shqiptar, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, lindur më 07.02.1987, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikues ID Nr. Personal 170207013P.
- 9.2 Administratori emërohet me një afat 5 (pesë) vjeçar, duke nisur nga data 10/04/2025 deri në 10/04/2030, me të drejtë riemërimi. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- 9.3 Administratori kryen detyrat dhe ushtron kompetencat në përputhje me statutin dhe dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
- 9.4 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 10

Viti Financiar

- 10.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 10.2 Në rast se Shoqëria do të jetë subjekt auditimi ligjor, ajo do të përcaktojë Audituesin/it ligjorë (Ekspertin Kontabël të Autorizuar), i cili ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kryerjes së detyrës së ngarkuar, ai do të lëshojë raportin e auditimit apo gjetjeve sipas procedurave të dakortësuara, në lidhje me nëse pasqyrat financiare dhe/apo llogaritë kontabël japin një

pamje të drejtë dhe të vertetë të situatës financiare të shoqërisë në përputhje me kuadrin ligjor financiar raportues në fuqi.

Neni 11

Baza Ligjore

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi/Statut, dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.

11.2 Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi/Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 12 Depozitimi Aplikimit për Regjistrim

12.1 Ortaku themelues autorizon Z. Rrok Gjoka për aplikimin dhe depozitimin e dokumentacionit pranë QKB, me qëllim regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar.

Neni 13

Dispozita përfundimtare

13.1 Ky Akt Themelimi u redaktua në 1 ekzemplar, në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua rregullisht nga Ortaku Themelues.


Unë, ortaku themelues, duke kuptuar dhe duke qënë i ndërgjegjshëm mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ky veprim, me vullnet të lirë e të plotë nënshkruaj si mëposhtë:

Ortaku themelues

Gjoka Konstruksion SHA

Përfaqësuar nga

Z. Rrok Gjoka


(Emër, Mbiemër, Nënshkrim, Vullë)

